

FUQITË PERËNDIMORE DHE SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË

Recense libri

VJOSA MUSLIU*

The Hour of Europe: Western Powers and the Breakup of Yugoslavia. Josip Glaurdic. Yale University Press: New Haven, London. ISBN 978-0-300-16629-3. Book Review. *Vjosa Musliu.*

(*Ora e Evropës: Fuqitë Perëndimore dhe Shpërbërja e Jugosllavisë*; nga Josip Glaurdic. Yale University Press: New Haven, London. ISBN 978-0-300-16629-3. Recense libri nga Vjosa Musliu.)

*

Titulli i librit “Ora e Evropës: Fuqitë perëndimore dhe shpërbërja e Jugosllavisë” nga Josip Glaurdiq, në dukje të parë fton për një analizë të rolit të BE-së gjatë shpërbërjes së federatës jugosllave. “Kjo është ora e evropianëve...”, fjali kjo e përmendur nga ish kryesuesi i Komisionit Evropian, Jacques Poos në vigjilje tëkrizës në ish-Jugosllavi, është bërë një togfjalësh që simbolizon ironinë e asaj që BE-ja dështoi tësjellë ne Jugosllavi nëkuptimin e një qëndrimi dhe veprimi të unifikuar supranacional. Në të kundërtën, libri në përgjithësi fokusohet më tepër në dinamikën brenda përbrenda Jugosllavisë, proceseve dhe zhvillimeve të cilat çuan në ndryshime politike, se sa qëofron ndonjë vëmendje të veçantë në mënyrën se si BE-ja u mor me krizën në përgjithësi. Libri vë përballë njëri-tjetrit bartjen e përgjegjësisë për Jugosllavinë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të Bashkimi Evropian, transfer ky i cili për disa autorë konsiderohet i ngadaltë e për disa të tjerë arsyetohet në baza të gjeopolitikës dhe të sigurisë.

Libri raporton se si zhvillimet politike në ish Jugosllavi duket të kenë kapur në befasi shumë prej atyre të cilët ende e ruanin imazhin e një Jugosllavie përparuar të Titos. Shumë autorë, sidomos ata nga fusha e shkencave politike, kur shkruajnë për marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Jugosllavisë, kanë tendencën ta shohin BE-në si një qëndër e unifikuar, duke presupozuar kështu ekzistimin e një qëndrimi tëmirë-vendosur Evropian. Për dallim, Glaurdiq fokusohet në veprimet diplomatike dhe fërkimet për balancim të fuqive ndërmjet Francës dhe Gjermanisë, ndërsa më pak vëmendje duket ti jepet rolit të Britanisë së Madhe në ish Jugosllavi.

Libri sjell një përshkrim të shkëlqyer të shpërbërjes së Jugosllavisë që nga vdekja simbolike dhe qenësore e presidentit Tito deri te shpërbërja ligjore në 1992. Autori vë në pah një konglomerat të tërë të aktorëve politik, faktorëve social dhe ekonomik, si dhe rolin e posaçëm të elitës, klasës akademike dhe medias në Serbi. Ardhja e Millosheviqit në pushtet rastisi me rritjen e nacionalizmit në Serbi, e cila pati efekt domino edhe në republikat tjera. Kjo gjëçoi në krijimin e një situatë të mbushur me pabesi ndërmjet popujve të federatës. Ngjarjet që ndodhën në vazhdim nuk ishin në agjendën e BE-së. Për shkak të mungesës së njëqasjetë unisuar të BE-së përkitazi me atë se çfarë veprimesh duhej të ndërmerreshin, politika e jashtme e BE-së ngeli në atë që di të bëjë më së miri – ruajtjen e status kuos. Glarudiq vë re se përshkak të mungesës së informacioneve për rajonin të “fuqitë perëndimore”, BE-ja po mundohej të ruante status kuon, duke nënvizuar se duhej të ruhej tërësia e Jugosllavisë. Për dallim nga diskursi në nivelin supranacional, ndarjet veçse kishin filluar brenda shteteve anëtare të BE-së, në mes të Gjermanisë dhe Austrisë që përkrahnin

* Bio: *Vjosa Musliu* ështëkandidate për PhD në Qendrën për Studime Evropiane në Universitetin e Gentit në Belgjikë. Tema e saj merret me misionin e BE-së nëKosovë, dhe autorja është e specializuar në marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Znj. Musliu është diplomuar nëMarrëdhënie Ndërkombëtare dhe Shkenca Politike nëUniversitetin e New York-ut në Tiranë. Ajo ka përfunduar studimet master për Politika dhe Qeverisje Evropiane nëUniversitetin Katolik të Luvenit.

procesin e shpërbërjes dhe Francës në anën tjetër që e kundërshtonte atë. Diskursi i paqartë BE-së I cili më vonë rezultoi edhe në mosveprim konkret ndaj krizës, i dha Millosheviqit dorë të lirë në luftën me Bosnje Hercegovinën, duke e bërë këtë “gabimin më të madh të BE-së”.

Nga njëra anë, libri ofron një analizë të thukët, të bazuar në një mbledhje të pasur dhe të shumëllojshmetë të dhënave parësore dhe dytësore, përfshirë këtu edhe dokumente zyrtare tëpa-publikuara të CIA-s dhe Zyrës së Jashtme, 80 intervista dhe monitorim të mediave. Kësaj i shtohen edhe vlera e mbi 200 bisedave tëshkëputura telefonike të njerëzve të afërt me Millosheviqin dhe biseda tjera “anonime” të asaj kohe, materiale të cilat e kompletojnë figurën në formë tejet origjinale. Duhet thënë se në masë të madhe, literatura për intervenimet qofshin ato civile ose ushtarake, vazhdon të mbetet euro-centrike. Për me tepër, autorët e huaj që shkruajnë për ish-Jugosllavinë kanë tendencën (me ose pa vetëdije) të përcjellin një dozë tëorientalizmit, duke krijuar kështu ‘Ballkanizimin’ si kategori për të shpjeguar lumin e konflikteve. Duke qenë familjarizuar me kontekstin lokal në formë më personale, Glaurdiq i shpjegon zhvillimet në ish-Jugosllavi duke i kontekstualizuar ato në literaturën e formimit të shteteve kombe dhe konflikteve ndër-shtetërore. Ai hedh dritë se si problemet ekonomike të Jugosllavisë u instrumentalizuan nga elita politike (kryesisht nga elita në Serbi) për ngritjen e nacionalizmit dhe ksenofobisë, ndjenjën e sigurizimit dhe krizës në republikat tjera, krijimin dhe fabrikimin e ‘tjetrit’ dhe ‘armiqëve’ dhe instrumentalizimin e mëtejshëm të minoriteteve. Përpos kësaj, autori hedh dritë edhe mbi dinamikat gjeopolitike dhe rolin e tyre në zhvillimet nëish-Jugosllavi. Ai poashtu sjell një pasqyrë të qartë të problemeve të brendshme politike, identitare brenda Serbisë, elemente të cilat shpesh neglizhohen.

Në anën tjetër, libri shfaqet i mangët në analizën për rolin e Bashkimit Evropian, si strukturë supranacionale. Edhe pse roli i BE-së vihet në pah në fragmente analizash tëzhvillimevepolitike, mungon një analizë mëgjithëpërfshirëse dhe sistematike. Libri poashtu nuk merret me ndryshimet ligjore që Millosheviq i bëri në kushtetutën e vitit 1974, veprim me të cilin të drejtat e zgjeruara të autonomisë së Kosovës u anuluan. Kjo ngjarje është e rëndësishme për pasojat që pati më vonë në ndryshimin e strukturës ligjore të federatës në tërësi. Si përfundim, duhet shtuar se koha në të cilën libri fokusohet (1987-1992) është shpërbërja e Jugosllavisë e vitit 1992 në kuptimin ligjor. Megjithatë, spiralja e shpërbërjes nuk duket të ketë përfunduar deri më sot. Lexuesi do të kishte përfituar nga një analizë mëe detajuar e etapave tjera të shpërbërjes, posaçërisht me krizën politike në Maqedoni, pavarësinë e Malit të Zi dhe për fund me krizën e Kosovës. Kjo jo vetëm për ta kompletuar shtjellimin në tërësi, por gjithashtu për të dhënë pasqyrën me të gjerë të ngjarjeve.

Për fund, libri është një kontribut unik për literaturën në fjalë në tri forma kryesore. Së pari, ofron analizën e pasur të aspekteve politike, ekonomike, sociale, identitare dhe gjeopolitike të cilat formuan mozaikun në shpërbërjen e Jugosllavisë. Në përgjithësi, të dhënat dhe literatura mbi Jugosllavinë ka tendencën të shohë zhvillimet e viteve 90-ta në vakum, duke neglizhuar një numër të faktorëve social, rajonal dhe ideologjik. Së dyti, libri është një kontribut i çmuar në literaturën empirike duke ofruar një sërë të dhënash parësore. Së treti, për dallim prej shumë autorëve që shkruajnë për këtë temë, autori sjell njohuri të thella, tëmirëpersonalizuara dhe tëmirëvendosura në kontekst. Pa e futur daljen jashtë binarëve të Jugosllavisë federale në linja të fenomeneve të ‘Ballkanizimit’, Glaurdic kristalizoi problemin duke e vënë atë në sintezë të problemeve ekonomike, politike dhe nacionaliste.

© DKE 2013.

<http://www.southeast-europe.org>
dke@southeast-europe.org

*

Shënim: të respektuar kërkues noqëftëse bëni një referim të ky artikull ose përmëndeni një pjesë të tij, ju lutemi në çoni një e-mail në adresën: dke@southeast-europe.org që të na bëni njoftim. *Ju lumi shënoni artikullin kështu:*

Vjosa Musliu: Fuqitë Perëndimore dhe Shpërbërja e Jugosllavisë. *Dëlkelet Európa – South-East Europe International Relation Quarterly* (Vjeshtë 2013) 2 p.

Faleminderit për mirëkuptimin. *Kryedaktori.*